



**PUNË SOCIALE SHKOLLORE KA NË TË
GJITHA SHKOLLAT E QYTETIT THUN
NGA KOPSHTI I FËMIJËVE DERI
NË KLASËN E 9-TË**

A i keni të njohura këto?

„Fëmija im kohën e fundit tërhiqet në vetvete.“

„Fëmija jonë bën atë që dëshiron.“

„Ndonjëherë ne kemi grindje të mëdha në shtëpi.“

„Fëmija jonë nuk shkon më, me dëshirë në shkollë.“

„Fëmija im ka frikë nga ngacmimet gjatë rrugës për në shkollë.“

„Ndonjëherë ne si prindër jemi të pasigurt ose ndihemi të pafuqishëm.“

Të jesh prind nuk është çdo herë e lehtë!

Puna sociale shkollore mund t'ju mbështesë në detyrën tuaj të vështirë. Ne i këshillojmë prindërit dhe fëmijët e tyre me shkollim të detyrueshëm dhe së bashku kërkojmë zgjidhje për:

- Pyetjet rreth çështjeve të edukimit si rregullat familjare, parat e xhepit, sjellja gjatë kohës së lirë, përdorimin e telefonave celular, PC (kompjuterëve), televizorit.
- Konfliktet, mosmarrëveshjet apo dhuna në shtëpi ose në shkollë
- Pyetjet rreth dhunës, drogës, seksualizmit, internetit dhe social media-ut
- Problemet familjare
- Problemet me nxënësit dhe nxënëset e klasës
- Pyetjet rreth organizimit të kohës së lirë dhe ofertave për kohën e lirë

A keni pyetje, shqetësime ose çështje të tjera në lidhje me fëmijën tuaj? Puna sociale shkollore ju ndihmon më tutje juve dhe fëmijës tuaj. Nëse është e nevojshme ne do tju vëmë në kontakt me organe të tjera përkatëse. Këshillat tona janë falas dhe të besueshme.

Punën sociale shkollore mund ta gjeni

thun.ch/ssa

përmes mësimdhënësve të fëmijës tuaj